



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Korçë, më 19/12/2016

RAPORT I MBAJTUR NË TAKIMIN E BUXHETIMIT ME PJESËMARRJE ME BANORËT
NJËSIVE ADMINISTRATIVE VOSKOP

Morën pjesë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo, staf i bashkisë, banorë të njësisë administrative Voskop dhe organizata të tjera .

Në vijim të procesit të përgatitjes së projektbuxhetit për vitin 2017 takuam banorët e Njësisë Administrative Voskop në datë 19/12/2016 për të vendosur së bashku prioritetet e investimeve me qëllim përmirësimin e jetesës në çdo fshat ku ata jetojnë. Një diskutim i cili u mbështet tek punët dhe investimet e kryera gjatë kësaj kohe si dhe kërkesat e nevojat e tyre prioritare në lidhje me vazhdimësinë e punës për përmirësimin e ndriçimit publik, përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm, sistemimin e rrugëve hyrëse në fshatra dhe rrugëve dytësore në parcelat bujqësore si dhe zgjidhjen e çështjes së AMTP-ve për disa prej tyre.









